

“Drejtësi për vëllanë tonë”,
në Podujevë mbahet marsh
për Luzim Fejzullahun | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HISTORIKE

TALAT XHAFERI, KRYEMINISTRI I PARË SHQIPTAR I MAQEDONISË SË VERIUT

| FAQE 4-5



Talat Xhaferi është zgjedhur të dielën kryeministër i Qeverisë teknike të Maqedonisë së Veriut, duke u bërë shqiptari i parë që do ta

mbajë këtë pozitë në këtë shtet. Për zgjedhjen e ekzekutivit, që ka mandat prej 100-ditësh, votuan 65 deputetë, 3 ishin kundër dhe asnjë

abstenim. Qeveria teknike e Xhaferit ka mandat për organizimin dhe mbarrëvajtjen e zgjedhjeve parlamentare të caktuara për 8 maj

AKTUALE



UKRAINA ZBULON NJË SKEMË TË
MADHE KORRUPTIVE NË USHTRI | F. 2

ABDIXHIKU NË VUSHTRRI DHE KLINË:
KOHA JONË PO VJEN! | F. 3

DIGJET MAKINA E KRYETARIT TË
KUVENDIT KOMUNAL TË LEPOSAVIQIT | F. 6

EKONOMI



QUINTI KËRKON PEZULLIMIN
E ZBATIMIT TË VENDIMIT
TË BQK-së PËR DINARIN | F. 7

“KY ËSHTË VENDI IM”,
LIBERALIZIMI I VIZAVE S’I LARGON
TURISTËT KOSOVARË NGA BOGA | F. 7

SPORT



PEJA PA PROBLEM MPOSHTI
ISTOGUN, TREPÇA REGJISTRON
FITOREN E DYMBËDHJETË | F. 10

DARDAN MOLLIQAJ RIZGJEDHET KRYETAR I PSD-së

| F. 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Luftanija britanike zbraps një sulm të Huthëve

LONDËR, 28 JANAR - Sekretari britanik i Mbrojtjes, Grant Shapps, tha se Mbretëria e Bashkuar vazhdon të jetë "e patrembur" pasi anëtarët e lëvizjes rebele jemenase, Huthi, tentuan ta sulmonin një luftanije britanike në Detin e Kuq.

"Dje [e shtunë, 27 janar] anija HMS Diamond me sukses ka zbrapsur një sulm me dronë në Detin e Kuq nga Huthët që mbështeten nga Irani", shkroi Shapps në X, që më herët njihet si Twitter.

Ai i cilësoi sulmet e vazhdueshme ndaj anijeve nga Huthët si "të patolerueshme dhe të jashtëligjshme". "Me

dislokimin e sistemit raketor Sea Viper, Diamond shkatërroi dronin që ishte nisur" drejt luftanijes, tha Shapps.

Nuk raportohet për të lënduar apo dëme në anijen Diamond.

Forcat e Shteteve të Bashkuara dhe Britanisë më 12 janar kanë kryer sulmet e para të përbashkëta, që synojnë t'i shkurtojnë aftësitë e Huthëve për t'i goditur anijet që kalojnë përmes rrugës kyçe në Detin e Kuq.

Rebelët kanë thënë se sulmet e tyre ndaj anijeve janë në mbështetje të palestinezëve në Rripin e Gazës, ku Izraeli po lufton me Hamasin, grupin palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe

Bashkimi Evropian.

Huthët nisën t'i shënjestronin anijet në Detin e Kuq në nëntorin e vitit të kaluar.

Uashingtoni, po ashtu, ka kryer sulme të njëanshme, por Huthët janë zotuar se do t'i vazhdojnë sulmet e tyre.

Rebelët që janë pjesë e aleancës së bashkëpunëtorëve të Iranit kundër Izraelit dhe Perëndimit kanë penguar tregtinë në Detin e Kuq, ku kalon rreth 12 për qind e trafikut detar ndërkombëtar.

Disa kompani të dërgesave të mallrave po shmangin ujërat e Detit të Zi dhe po përdorin rrugë më të gjata dhe më të shtrenjta përreth Kepit të Shpresës së Mirë në Afrikën e Jugut.



Ukraina zbulon një skemë të madhe korruptive në ushtri

Kiev, 28 janar - Shërbimi i sigurisë i Ukrainës njoftoi se ka zbuluar një skemë për përvetësimin e rreth 40 milionë dollarëve të destinuar për të blerë predha mortajash për ushtrinë e këtij shteti.

Shërbimi i Sigurisë së Ukrainës (SBU) njoftoi mbrëmjen e 27 janarit se pesë persona janë akuzuar për këtë skemë dhe një prej tyre u arrestua teksa po tentonte të largohej nga shteti. Nëse gjenden fajtorë, ata mund të dënohen deri me 12 vjet burgim.

Hetimi erdhi përderisa Kiev po tenton ta luftojë korrupsionin me qëllim që ta përshpejtojë anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe NATO. Zyrtarët e këtyre dy institucioneve kanë



kërkuar reforma të gjera para se Kiev të mund të anëtarësohet.

SBU-ja tha se hetimi "ka ekspozuar zyrtarë nga Ministria e Mbrojtjes dhe menaxherët e furnizuesit të armëve, Lviv Arsenal, që vodhën pothuajse 1.5 milion hryvnya [monedha kombëtare e Ukrainës] për blerjen e predhave". "Sipas hetimit, zyrtarë dhe ish-zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe krerët e kompanive të lidhura ishin të përfshirë në këtë skemë mashtrimi".

Sipas hetimit, me paratë është dashur të blihen 100 000 predha të mortajave për ushtrinë.

Pasi kanë pranuar pagesën, punonjësit e kompanisë është

dashur t'i transferojnë fondet të një biznesi i regjistruar jashtë, i cili më pas do ta dërgonte municionin në Ukrainë.

Megjithatë, mallrat nuk u dërguan kurrë në Ukrainë dhe paratë u dërguan në disa llogari në Ukrainë dhe Ballkan, thanë hetuesit.

Fondet janë sekuestruar dhe do të kthehen në buxhetin e mbrojtjes së Ukrainës, tha Prokurori i Përgjithshëm i Ukrainës.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ishte zgjedhur në këtë pozitë më 2019 në bazë të një platforme kundër korrupsionit, tre vjet para se Rusia ta niste pushtimin e paprovokuar të Ukrainës.

OKB bën thirrje për vazhdimin e financimit të agjencisë së ndihmës në Gazë

NJU-JORK, 28 JANAR - Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara u ka bërë thirrje shteteve që ta vazhdojnë financimin e agjencisë kryesore që ofron ndihmë në Gazë, pasi dhjetëra punëtorë të agjencisë u akuzuan se kanë marrë pjesë në sulmin në Izrael që nxiti luftën katër muaj më parë.

Më 7 tetor, Hamas, grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian, sulmoi jugun e Izraelit, duke nxitur luftën e fundit. Mosmarrëveshjet lidhur me agjencinë kryesore që dërgon ndihmë për palestinezët vijnë në kohën kur zyrtarët amerikanë thanë se negociatorët janë afër arritjes së një marrëveshjeje armëpushimi. Një marrëveshje e tillë do të mundësonte dy muaj ndalje të dhunës më vdekjeprurëse ndonjëherë mes izraelitëve dhe palestinezëve, që ka nxitur paqëndrueshmëri në

mbarë Lindjen e Mesme.

Antonio Guterres paralajmëroi se agjencia e OKB-së për refugjatët palestinezë, e njohur me akronimin UNRWA, do të detyrohet ta shkurtojë ndihmën për më shumë se 2 milionë palestinezë në shkurt. Enklava bregdetare është mbërthyer nga një krizë e rëndë humanitare, me çerekun e popullsisë që po përballet me uri. "Aktet e neveritshme të supozuara të këtyre anëtarëve të stafit duhet të kenë pasoja", tha Guterres përmes një deklaratë. "Por, dhjetëra mijëra burra dhe gra që punojnë për UNRWA-në, shumica nga të cilët punojnë në situatat më të rrezikshme për punëtorët humanitarë, nuk duhet të penalizohen. Nevojat e mëdha të popullatës së dëshpëruar për të cilët ata shërbejnë, duhet të përmbushen", shtoi ai.

Ai tha se nga 12 punëtorët e akuzuar për pjesëmarrje në

sulm, nëntë janë larguar nga puna menjëherë, një është konfirmuar i vdekur dhe "identiteti i dy të tjerëve duhet të qartësohet". Guterres tha se të gjithë do të mbahen përgjegjës, përfshirë edhe me ndjekje penale.

UNRWA ka një staf prej 13 000 personash në Gazë, pothuajse të gjithë palestinezë. Kjo agjenci ofron shërbimet bazike, nga kujdesi shëndetësor e deri tek edukimi për familjet palestineze që janë larguar nga ai që është Izraeli i sotëm gjatë luftës së vitit 1948, rreth periudhës kur u krijua Izraeli. Kjo agjenci ka zgjeruar operacionet gjatë luftës, duke udhëhequr vendstrehime ku po strehohen qindra mijëra persona të zhvendosur së fundi.

Mbi 2 milionë nga 2.3 milionë banorë të territorit varen "për mbijetesë" nga agjencia, përfshirë për furnizime ushqimore dhe strehim, tha drejtori i UNRWA-së, Philippe



Lazzarini, duke paralajmëruar se kjo ndihmë "mund të kolapsojë tani në çdo kohë".

ShBA-ja, që është donatorja më e madhe e agjencisë, menjëherë pezulloi ndihmën gjatë fundjavës, dhe njësoj vepruan edhe shtete të tjera sikurse Britania, Gjermania dhe Italia. Në luftën Izrael -Hamas janë

vrarë mbi 26 000 palestinezë sipas zyrtarëve lokalë shëndetësorë, janë shkatërruar pjesë të mëdha të Gazës dhe është zhvendosur pothuajse 85 për qind e popullsisë së territorit. Gjatë sulmit të Hamasit në jug të Izraelit janë vrarë rreth 1 200 persona, shumica civilë, dhe janë rrëmbyer rreth 250 të tjerë.

Dardan Molliqaj rizgjedhet kryetar i PSD-së

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 JANAR - Partia Socialdemokrate ka mbajtur të dielën Kuvendin Zgjedhor. Në krye të kësaj partie është rizgjedhur Dardan Molliqaj.

Molliqaj ka bërë me dije se në këtë Kuvend Zgjedhor është zgjedhur edhe Këshilli i ri Drejtues që, sipas tij, e ka rritur numrin sepse aktiviteti është rritur. "Kuvendin Zgjedhor të PSD-së. Bashkë me shumë delegatë, aktiviste e aktivistë, të përkushtuar dhe në frymë bashkëpunimi, kemi kryer punimet drejt rritjes dhe konsolidimit. Sot është zgjedhur Këshilli i ri Drejtues, Këshill ky që e ka rritur numrin sepse aktiviteti është rritur. Sot gjithashtu, përmes një procesi të fshehtë zgjedhor më është besuar udhëheqja e PSD-së për katër vitet e ardhshme. Besimin e dhënë e kuptoj si thirrje për ta rritur përkushtimin dhe punën ekipore. PSD me punën e saj është dëshmia se mund të jesh edhe idealist e radikal, edhe demokrat", ka shkruar Molliqaj në "Facebook".

Ai gjatë fjalës së tij ka theksuar se PSD-ja është themeluar në kushte të rënda. "Ne e kemi filluar aksionin politik kundër pushtetit kur numrat arritën

kulmin, kurse propaganda qiellin. Në kushte të tilla horizontet mbyllen dhe e vërteta vështirë mendohet. Në këto kushte, edhe për njerëzit normal thjesht kritika duket marrëzi. Ne kemi zgjedhur të veprojmë në këto kushte. Në kushtet kur vala e madhe i merr të gjithë: i merr ata që e mendojnë karrierën; i merr oportunistët që sa herë ndërrohet pushteti e rizbulojnë vetveten në rrobën e re; i heshtë edhe mendjet e ftohta sepse zjarri i etiketave, sharjeve e linçimeve nuk lë hapësirë për normalitetin e tyre", ka thënë Molliqaj.

Ai ka shtuar se këtë vit kanë dy beteja me rëndësi. "Ky vit do të nisë instalimin e autonomisë për serbët në Kosovë. Duke besuar thellësisht që kjo do të çojë vendin në ndarje edhe më të thellë dhe shoqërinë edhe më shumë në konflikt, është detyrë e jona të punojmë me qytetarët për ta kundërshtuar një projekt të tillë. Beteja e radhës për PSD është strukturimi dhe shtrija në qytete dhe fshatra. Prandaj ftoj secilin që të bashkohet në punë me ne për këtë qëllim. Por mos të harrojmë sfidën tonë që kemi përpara për ta bërë partinë tone parlamentare. Unë besoj fuqishëm që nuk ka asgjë më të rëndësishme për demokracinë dhe parlamentarizmin në



Kosovë sesa PSD të bëhet forcë parlamentare në zgjedhjet që kemi përpara", ka thënë ai. Molliqaj ka theksuar se kur qytetari e përfytyron parlamentin e ardhshëm është e

qartë që veç një gjë e bën dallimin. "Nuk është numri i ndryshëm i deputetëve të VV, PDK, LDK, apo AAK por prezenca e deputetëve të PSD-së. Ju ftoj juve këtu e qytetarët

jashtë që te bashkohemi në këtë përpjekje të rëndësishme. Unë besoj të ju dhe qytetarët, prandaj besoj edhe më fuqishëm në këtë fitore", është shprehur Molliqaj.

Kurti bëri homazhe te lapidari i Memë dhe Prend Zef Lleshit në 25-vjetorin e rënies së tyre



GJAKOVË, 28 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga anëtarë të familjes Lleshi dhe me bashkëpunëtorë nga Gjakova, ka bërë të dielën homazhe dhe ka vënë lule të freskëta te varrezat e dëshmorëve në Vraniq të Gjakovës, në 25-vjetorin e rënies së dëshmorëve Memë dhe Prend Zef Lleshi. Me këtë rast, kryeministri Kurti tha se familja Lleshi, sikurse edhe shumë familje të tjera në Kosovë, kanë kontribuar për çlirimin e vendit, andaj sot kujtojmë me krenari dy anëtarët e kësaj familje, Memë e Prend Lleshin, të cilët ranë heroikisht në ballafaqim të drejtpërdrejtë me forcat armike serbe. "Aty prehen në varre të katër bijtë e familjes Lleshi, dëshmorë të kombit, luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të rënë në betejë të drejtpërdrejtë për lirinë e atdheut. Ata janë: Mark Lleshi, Kolë Gjon Lleshi,

Memë Zef Lleshi dhe Prend Zef Lleshi. Mema dhe Prendi ranë dëshmorë 25 vite më parë, më 28 janar 1999, në luftime me forcat e Serbisë në Goden të Hasit, kurse Marku me Kolën qenë përjetësuar si dëshmorë më 7 gusht 1998, në luftimet që kanë marrë emrin beteja e Markalleshëve", tha kryeministri Kurti.

Duke kujtuar sakrificën e kësaj familjeje, ai tha se angazhimi dhe lufta totale e familjeve shqiptare sikur rasti i familjes Lleshi, e kanë shtruar rrugën nëpër të cilën është ecur deri te liria e Kosovës. "E gjithë përpjekja dhe flijimi i dëshmorëve dhe martirëve të popullit shqiptar, është e monumentalizuar si sakrificë në themelet e Republikës së Kosovës, shtetit tonë që duam, që duhet dhe që po përpiqemi ta bëjmë çdo ditë e më të fortë", tha kryeministri.

Abdixhiku në Vushtrri dhe Klinë: Koha jonë po vjen!

VUSHTRRI, 28 JANAR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se të dielën ka pasur aktivitete

politike në Vushtrri dhe Klinë. "Dy anë, një histori, një qëllim, një vizion. Në nderim të së shkuarës, ndërtojmë të ardhmen! Lidhja është e fortë.

Koha jonë po vjen!", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook". Dy ditë më parë Abdixhiku në Rugovë të Pejës ka mbajtur takim pune me

nënkryetarë, sekretarë, drejtues parlamentarë e me dy forumet. "Drejt mobilizimit të madh", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".





HISTORIKE

Talat Xhaferi, kryeministri i parë shqiptar i Maqedonisë së Veriut

Talat Xhaferi është zgjedhur të dielën kryeministër i Qeverisë teknike të Maqedonisë së Veriut, duke u bërë shqiptari i parë që do të mbajë këtë pozitë në këtë shtet. Për zgjedhjen e ekzekutivit, që ka mandat prej 100-ditësh, votuan 65 deputetë, 3 ishin kundër dhe asnjë abstenim. Qeveria teknike e Xhaferit ka mandat për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve parlamentare të caktuara për 8 maj

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 28 janar - Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ka votuar të dielën qeverinë teknike të cilën do ta drejtojë Talat Xhaferi, ish-kryetar i Kuvendit. Kjo është hera e parë që një shqiptar e merr pozitën e kryeministrit në Maqedoninë e Veriut. Qeveria teknike ka si detyrë kryesore përgatitjen e zgjedhjeve që do të mbahen më 8 maj. Dy pjesëtarë të opozitës maqedonase do të jenë ministra të rinj në kabinetin e Xhaferit. 65 ligjvënës votuan për, ndërsa 3 ishin kundër. Deputetët e opozitës shqiptare, që përbëjnë Lëvizjen Evropiane

për Ndryshim, e bojkotuan seancën, teksa VMRO-DPMNE-ja e opozitës maqedonase abstenoj gjatë votimit, ndonëse dy ministra të saj janë pjesë e kabinetit qeveritar dhe tre zëvendësministra do të jenë nga radhët e saj. Gjatë debatit parlamentar, Xhaferi paraqiti programin e punës së qeverisë, e cila do të ketë mandat prej 100-ditësh për organizimin dhe mbarëvajtjen e zgjedhjeve parlamentare të caktuara për 8 maj. Xhaferi, që më herët ka mbajtur pozitën e kryetarit të Kuvendit, tha se pa marrë parasysh se sa gjatë do të jetë në krye të qeverisë, ai do të bëjë gjithçka për t'i

përmbushur detyrimet, në përputhje me Kushtetutën dhe pritjet e qytetarëve. "Prioritet i parë do të jetë organizimi i zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale në mënyrë të rregullt dhe demokratike. Për mua si mandatar, pa marrë parasysh nëse do ta drejtoj këtë qeveri një ditë apo 100 ditë, unë këtë detyrë, këtë përgjegjësi dhe besimin e dhënë do ta kryej me përgjegjësi, ashtu siç kam vepruar edhe me sfida të tjera që ishin para meje. Për asnjë moment nuk do të lëshoj pe nga ajo që nënkupton qeveri efikase, funksionale dhe përgjegjëse. Unë dhe qeveria do të vazhdojmë të punojmë për realizimin me sukses dhe efikasitet të plotë të politikave të qeverisë", tha Xhaferi. Mandatari për formimin e qeverisë teknike tha se ekzekutivi që ai do të drejtojë, do të mbetet i fokusuar në agjendën evropiane dhe zhvillimin ekonomik të vendit, rritjen e pagave dhe pensione, uljen e çmimeve të produkteve ushqimore dhe uljen e inflacionit. "Qeveria do të mbetet e përkushtuar në planin për rritje ekonomike, që është pjesë e planit për zgjerimin e Bashkimit Evropian... Lufta kundër ekonomisë joformale nuk do

të ndalet. Do të jemi transparentë në punën tonë dhe financat publike. Problemet e qytetarëve në nivel lokal, pavarësisht se të cilës komunë i takojnë, do ta kenë mbështetjen e plotë të pushtetit qendror", u shpreh Xhaferi. Partia maqedonase në opozitë, VMRO DPMNE, i cilësoi si "dezertorë" Xhaferin dhe ish-kryeministrin Dimitar Kovaçevski. Gjatë seancës së 28 janarit deputeti i VMRO-së, Antonio Milloshoski, tha se qytetarët e Maqedonisë së Veriut "nuk duhet të kenë asnjë pritje nga Talat Xhaferi ashtu siç nuk patën as nga Dimitar Kovaçevski". Gjatë debatit, kreu i Bashkimit Demokratik për Integritet, Ali Ahmeti, tha se maqedonasit nuk duhet të kenë frikë nga "barazia e popujve" që garantohet me Marrëveshjen e Ohrit, që ndaloi konfliktin e armatosur në vitin 2001. Kjo marrëveshje, sipas Ahmetit, ka sjellë stabilitet në Maqedoninë e Veriut, që tani është "shtëpi e përbashkët e të gjitha bashkësive etnike që jetojnë në të". "Varet nga të gjithë ne nëse këtë shtet do ta çojmë përpara apo do ta kthejmë pas. Këtë ua kam thënë të gjithë partnerëve. Unë

punoj për interesat e këtij shteti", tha kryetari i BDI-së. Ahmeti kundërshtoi deputetët e opozitës të cilët thanë se "BDI-ja e bëri Maqedoninë shtet qira për maqedonasit", ndërsa ata drejtuan edhe akuza ndaj zyrtarëve të BDI-së për përfshirje në "krim të organizuar dhe korrupsion". "Do të doja që ne të mos bëjmë këtu fjalime politike pasi zgjedhjet janë më 8 maj. Nuk duhet të luajmë rolin e gjykatës dhe të prokurorit. Ky është Kuvend ku sillen vendime të mëdha për të ardhmen e vendit, ndërsa për çështjet e tjera duhet të merren organet e ndjekjes", tha Ahmeti. Ai theksoi nevojën e një uniteti në shtet për ta arritur integritetin e tij në Bashkimin Evropian, ndërsa kujtoi rreziqet që vijnë nga Rusia, e cila, sipas tij, punon për destabilizimin e rajonit. "Moska ka uzurpuar Ukrainën. Ka shkelur sovranitetin e Ukrainës, andaj duhet të jemi të kujdesshëm se çfarë politikash do të udhëheqim", tha kreu i BDI-së. Xhaferi në pozitën e kryeministrit pason Dimitar Kovaçevskin, i cili dha dorëheqje bazuar në Ligjin për Zgjedhje, i cili parasheh që në 100 ditët para zgjedhjeve të

Rritja e pritur e së djathtës në PE mund të ndikojë në zgjerim

BRUKSEL, 28 JANAR - Partitë e ekstremist të djathtë në vendet e Bashkimit Evropian (BE) vazhdojnë të kenë rritje në mbështetjen e qytetarëve dhe pritet që të kenë sukses të konsiderueshëm në zgjedhjet e ardhshme evropiane që zhvillohen në 27 vende anëtare të bllokut mes 6 dhe 9 qershorit të këtij viti. Këtë e ka pohuar në një analizë së fundi Këshilli Evropian për marrëdhënie të jashtme (ECFR), një grup hulumtues që përgatit analiza politike.

Sipas anketave të fundit të matjeve në mesin e votuesve në vendet e BE-së, pritet që partitë e së djathtës ekstreme të shënojnë rritje të konsiderueshme të votave dhe si pasojë edhe të numrit të deputetëve në Parlamentin e ardhshëm Evropian pas zgjedhjeve të vitit 2024, në krahasim me numrin që aktualisht e kanë.

Nga ana tjetër, pritet që partitë e qendrës së majtë të kenë rënie dhe të humbasin vota. Por, diplomatët në BE janë të mendimit se është herët të parashihet për ndikimet që do të kenë ndryshimet në Parlamentin Evropian (PE) në zhvillimet në BE, pasi koalicionet mes grupimeve politike në PE dallojnë prej atyre në nivele nacionale dhe nuk kanë një model të caktuar. Prej kur ekziston PE-ja gjithmonë ato që quhen "grupi i qendrës pro-evropiane" kanë pasur shumicën e mjaftueshme për ta caktuar agjendën dhe për t'i kaluar vendimet në këtë institucion të BE-së. Në atë grup hyn Partia Popullore Evropiane (EPP) nga qendra e djathtë që ka numrin më të madh të vendeve, pastaj

socialdemokratët (S&D) që janë grupi i dytë dhe atyre u janë bashkuar edhe deputetët e grupit liberal. Por, si parti evropiane mund të quhen edhe të gjelbrit.

Këto katër parti, ndonëse kanë dallime sa iu përket disa politikave të BE-së, ato ndajnë përkushtimin se BE-ja nuk duhet të vihet në pikëpyetje dhe procesi i integritetit duhet të vazhdojë. Në këtë moment së bashku këto katër parti kanë 491 deputetë në Parlamentin Evropian që ka 705 ulëse.

Numri i tyre do të zvogëlohet dukshëm nëse realizohen parashikimet tashmë të bazuara në anketat e publikuara nga ECFR-ja. Ato në mandatin nga 2024 deri më 2029 do të mund të llogarisin në 451 ulëse, por në një parlament me 720 ulëse.

Në Bruksel dhe në qendrat e vendeve anëtare nuk kanë dyshim se e djathta ekstreme do të jetë më e zëshme në Parlamentin Evropian, sepse ky trend po shihet edhe në vendet anëtare që ka shkaktuar shqetësim. Partia e Lirisë e udhëhequr nga Geert Wilders, parti radikale në Holandë, ka dalë fituese në zgjedhjet e fundit në këtë vend dhe, nëse ka sukses në negociata, mund edhe ta formojë qeverinë.

Në Belgjikë në anketa udhëheq partia e Interesit Flaman, po ashtu parti kundër imigrantëve dhe radikale.

Në Gjermani rritja e mbështetjes për partinë Alternativa për Gjermaninë ka shkaktuar alarm dhe protesta në rrugë.

Në Francë mund të fitojë Lëvizja Nacionale e Marine Le Pen.



Edhe analiza e Këshillit Evropian për punë të jashtme parasheh se në nëntë vende anëtare partitë populiste të djathta do të dalin fituese. Do të performojnë mirë edhe në disa vende të tjera. Por, nga ana tjetër, ndikimi i tyre në Parlamentin Evropian mund të zvogëlohet shumë nëse do të ketë unitet nga kundërshtarët e tyre. Nuk janë as të gjitha partitë e ekstremist të djathtë me qëndrime të njëjta në nivel evropian. Ka shumë dallim mes tyre dhe nuk mund të krijojnë një grup homogjen. Disa nga partitë e tilla janë skeptike ndaj BE-së, por jo kundër saj.

Ka të tilla që duan edhe shuarjen e BE-së.

Disa parti të ekstremist të djathtë në Evropë janë shumë pro-Rusisë, si në Francë, Austri dhe Gjermani, ndërsa të tjerat janë kritike të mëdha të Rusisë, si ato në Poloni dhe Itali. Si shembull merret edhe Grupimi i Konservatorëve dhe Reformistëve (ECR). Sa iu përket qëndrimeve ndaj BE-së,

ky grupim është skeptik. Por, dallon shumë nga grupimet e së djathtës ekstreme. Këtë grupim e kishte themeluar Partia Konservatore Britanike në kohën kur Mbretëria e Bashkuar ishte ende anëtare e BE-së. Ishte formuar si reagim ndaj përpjekjeve për thellimin e integritetit evropian që çonin drejt federalizmit të BE-së. Ky grupim nuk është kundër Bashkimit Evropian, por insiston që institucionet e përbashkëta të BE-së të kenë sa më pak kompetenca dhe të ruhet sa më shumë sovraniteti i vendeve anëtare.

Analistët e Këshillit Evropian për çështje të jashtme mendojnë se rritja e së djathtës ekstreme do të ketë ndikim edhe në politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian, ndërsa votat e tyre mund të kenë pasojë edhe për drejtimin gjeostrategjik të BE-së në të ardhmen. "Parlamenti i ardhshëm Evropian mund ta bllokojë legjislacionin e nevojshëm për zbatimin e disa politikave të BE-së nga

ndryshimet klimatike deri te migracioni, zgjerimi dhe ndihma për Ukrainën", thuhet në analizën e këtij grupi.

Por, diplomatët në Bruksel janë të mendimit se edhe në përbërjen e ardhshme në Parlamentin Evropian do të ketë shumicë të mjaftueshme të deputetëve për ta siguruar mbështetjen e këtij institucioni të BE-së për zgjerimin si për vendet e Ballkanit Perëndimor, ashtu edhe për Ukrainën, Gjeorgjinë dhe Moldavinë.

Pasi Parlamenti Evropian miraton vendimet dhe rezolutat me parimin demokratik me shumicë votash, kjo shumicë në mbështetje të zgjerimit pritet të ruhet edhe në përbërjen e ardhshme pas zgjedhjeve të vitit 2024, sepse partitë më ekstremiste që janë kundër zgjerimit janë edhe kundër Bashkimit Evropian. Për to BE-ja jo vetëm se nuk do të duhej të zgjerohej, por nuk do të duhej as të ekzistonte. E ka parti në Parlamentin Evropian që nuk janë pjesë e grupit pro-BE të qendrës, si E Majta e Bashkuar dhe Konservatorët, që e mbështesin fuqishëm zgjerimin e BE-së, me kushtin që ky zgjerim të mos rezultojë me rritjen e kompetencave për institucionet e Bashkimit Evropian.

Sfidë më serioze për forcat politike të qendrës në BE do të jetë suksesi eventual i partive radikale në nivel kombëtar dhe ardhja e tyre në pushtet. Në atë rast ato do të kenë fuqi edhe në Këshillin Evropian kur ekziston mundësia e vetos. Por, në Parlamentin Evropian, ndonëse mund të ketë rritje të ndikimit, fuqia bllokuese e partive ekstreme mund të kufizohet.

zgjedhet një qeveri teknike, e cila ka mandat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Pjesë e qeverisë teknike është edhe partia maqedonase opozitare, VMRO DPMNE, e cila do ta udhëheqë Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe atë të Punës dhe Politikës Sociale. Në ekzekutivin teknik kjo parti ka edhe tre zëvendëskryeministra me kompetenca të veçanta.

Ndryshime në pozitat e tjera ministore nuk do të ketë. Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI), Lidhja Social Demokrate (LSDM) dhe Aleanca për Shqiptarët, do të vazhdojnë t'i udhëheqin ministrinë që aktualisht kanë nën drejtim.

Xhaferi në pozitën e kryeministrit teknik është caktuar nga BDI-ja, e cila seancën e ka cilësuar "ditë historike" për shkak se për herë të parë në këtë shtet një shqiptar do ta udhëheqë ekzekutivin. "Kryeministri shqiptar" ishte premtuar nga kryetari i BDI-së në zgjedhjet

Kush është Talat Xhaferi?

Talat Xhaferi lindi më 15 prill 1962 në fshatin Forinë të Gostivarit.

Ka përfunduar Akademinë Ushtarake në Beograd dhe Sarajevë. Nga viti 1985 deri në vitin 1991 ka shërbyer epror i lartë në Armatën Popullore të ish-Jugosllavisë. Ndërkaq, nga viti 1992 deri më 2001, ka qenë oficer i Armatës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2001 në Maqedoninë e Veriut, Talat Xhaferi u ishte bashkuar radhëve të Ushtrisë

Çlirimtare Kombëtare, që luftoi për të drejtat kombëtare të shqiptarëve në këtë shtet.

Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2002 Talat Xhaferi u zgjodh për herë të parë deputet në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut nga radhët e Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI).

Nga viti 2004 deri më 2006 ai shërbeu në pozitën e zëvendësministrit të Mbrojtjes.

Në zgjedhjet parlamentare në vitin 2008, Xhaferi sërish u zgjodh deputet, ndërkaq në vitin 2013 u emërua ministër i Mbrojtjes në qeverinë e Nikolla Gruevskit.

Nga viti 2014 deri në vitin 2016 sërish ushtroi pozitën e deputetit në Kuvendin maqedonas, ndërsa më 27 prill 2017 u zgjodh kryetar i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. Këtë pozitë Xhaferi e mbajti deri në caktimin mandatar për formimin e qeverisë teknike.

e vitit 2020, të cilat u fituan nga Lidhja Social Demokrate dhe, për rrjedhojë, kryeministër ishte zgjedhur Zoran Zaev, që atëkohë drejtonte LSDM-në.

Por, në marrëveshjen për formimin e qeverisë në vitin 2020, Ahmeti dhe Zaev ishin pajtuar që në 100 ditët e fundit të mandatit, qeveria teknike të drejtohej nga një kuadër i propozuar nga BDI-ja.

Pavarësisht se u bë pjesë e qeverisë, VMRO-ja deklaroi më herët se nuk do të votonte për Xhaferin "për shkak të shkeljeve të shumta që ka bërë derisa ishte kryetar i Kuvendit". "Ai është njeriu i cili nga fillimi i tij e deri tani në fund si kryetar i Kuvendit ka bërë shumë veprime kundërkushtetuese dhe kundërligjore, pavarësisht se të gjitha iniciativat e ngritura u

rrëzuan nëpër gjykatat dhe prokuroritë e kurdisura. Por, një ditë kur ato institucione do të lirohen nga prangat politike, do të ketë përgjegjësi për çdonjërin që ka shkelur ligjet", ka thënë drejtuesi i VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickovski.

Kundër zgjedhjes së Talat Xhaferit është shprehur edhe opozita shqiptare, e bashkuar në Lidhjen Evropiane për

Ndryshim. Edhe ajo e ka akuzuar Xhaferin për "shkelje të shumta" gjatë punës në cilësinë e kryetarit të Kuvendit maqedonas. "Talat Xhaferi është zgjedhja më e keqe që ka mundur të ofrojë BDI-ja. Pas 20 vjetësh në qeveri, BDI-së në pozita të larta i kanë mbetur njerëzit më të korruptuar dhe njerëzit që më së shumti i kanë bërë dëm çështjes shqiptare. Derisa ishte në krye të Kuvendit, [Xhaferi] ka udhëhequr vetëm politika të partisë së tij dhe jo ato që ishin në interes të qytetarëve", ka deklaruar Bilall Kasami, përfaqësues i Lidhjes Evropiane për Ndryshim.

Për votimin e qeverisë teknike kërkohet që të votonin së paku 61 nga 120 deputetët e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut. Edhe pa votat e VMRO DPMNE-së, shumica aktuale kishte numrin e nevojshëm për ta miratuar ekzekutivin e ri.

Në Shqipëri dhe Kosovë kanë dërguar urime për zgjedhjen e Talat Xhaferit kryeministër, duke e vlerësuar ngjarje historike.

"Drejtësi për vëllanë tonë", në Podujevë mbahet marsh për Lulzim Fejzullahun

PODUJEVË, 28 JANAR - Të dielën në Podujevë është mbajtur marshi për 18-vjeçarën Lulzim Fejzullahun i cili u rrah për vdekje nga dy të mitur më 14 janar. Në këtë marsh kanë marrë pjesë një numër i konsiderueshëm i qytetarëve, të cilët kërkonin drejtësi për rastin e Lulzim Fejzullahut.

"Gjaku, jo, nuk shitet", "Drejtësi për Lulzim", "Gjaku nuk është ujë", "Drejtësi për vëllanë tonë" ishin disa nga thirrjet e

qytetarëve.

Prokuroria ka vendosur masën paraburgimit për dy të miturit e dyshuar që morën pjesë në përleshjen fizike, pas së cilës Lulzimi mbeti i plagosur dhe më pas u dërgua për trajtim mjekësor në QKUK ku ndërroi jetë nga plagët e marra më 20 janar.

Rasti nga policia është cilësuar si vrasje e rëndë dhe është dënuar nga kryeministri Albin Kurti. "Vrasja mizore e Lulzim

Fejzullahut duhet të jetë alarm për të gjithë, përfshirë institucionet, për të punuar më shumë me të rinjtë dhe të rejtat, që të orientohen sa më shumë drejtë arsimimit dhe edukimit, në mënyrë që të mos e shohin dhunën si zgjidhje dhe që të qëndrojnë sa më larg sjelljeve agresive dhe akteve të dhunës që mund të përfundojnë me pasoja tragjike", kishte thënë Kurti gjatë vizitës për ngushëllime te familja e të ndjerit.




Digjet makina e kryetarit të Kuvendit Komunal të Leposaviqit

LEPOSAVIQ, 28 JANAR - Kryetarit të Kuvendit Komunal të Leposaviqit, Gorski Buriq, i është djegur vetura, ka njoftuar Policia e Kosovës. Sipas njoftimit, autoritetet e rendit thanë se dolën në vendin e ngjarjes pasi rreth orës 04:20 të 28 janarit pranuan informatën se në Leposaviq po digjej një veturë me targa RKS - Republika e Kosovës. "Në afërsi të veturës, te motori, është hasur një shishe plastike dhe një leckë e cila kundërmon në benzinë, e që dyshohet se është vendosur si ndezës për ta djegur veturën", u tha në njoftim.

Policia shtoi se po ndërmerret të gjitha veprimet për të hetuar këtë rast që është iniciuar si "zjarrvënie".

Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës ka dënuar sulmin ndaj kryetarit të Kuvendit Komunal të Leposaviqit, duke thënë se kjo ngjarje dëshmon se "Serbia nuk ka ndryshuar qasjen dhe sulmet e saj kriminale ndaj qytetarëve serbë që janë besnikë ndaj institucioneve të Kosovës". "Ky akt është në vazhdim të djegieve të njëpasnjëshme të veturave të qytetarëve serbë që bashkëpunojnë apo angazhohen në institucionet e Republikës sonë", u tha në reagimin e MPB-së.

Sipas MPB-së, sulmet ndaj



qytetarëve serbë që angazhohen në institucionet e Kosovës kanë për synim të krijojnë "pasiguri të qytetarët tanë dhe të përcjellin edhe mesazhin e fatit të atyre që duan të angazhohen në institucionet tona".

Në të kaluarën, në komunat në veri të Kosovës, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut, ishin djegur apo dëmtuar vetura me targa RKS.

Serbët në veri të Kosovës për një kohë të gjatë kishin kundërshtuar një vendim të Qeverisë së Kosovës që targa e makinave të lëshuara nga

Serbia - që Prishtina i konsideron ilegale - të konvertohen në targa RKS - Republika e Kosovës. Por, muajt e fundit u rrit interesimi i serbëve në Kosovë për t'i konvertuar targat në RKS.

Së fundi, Kosova dhe Serbia kanë nisur të lejojnë që makinat me targat e shteteve respektive të mund të lëvizin lirshëm pa pasur nevojë që simbolet shtetërore në targa të mbulohen me letra ngjitëse.

Për çështjen e lëvizjes së Lirë, Kosova dhe Serbia kishin arritur marrëveshje më 2011 në kuadër të dialogut për normalizimin e raporteve që

ndërmjetësohen nga blloku evropian. Makinat ishin lejuar të kalonin, ndërkaq simbolet shtetërore në targa ishin mbuluar me letra ngjitëse.

Para praktikës së letrave ngjitëse automjetet me targa RKS detyroheshin të merrnin targa provuese në kufirin me Serbinë, që vlenin 60 ditë dhe kushtonin 5 euro. Por, më 20 shtator të vitit 2021 Qeveria e Kosovës vendosi masën e reciprocitetit, që detyroi edhe shoferët nga Serbia ta kalonin të njëjtën procedurë për të hyrë në Kosovë.

Por, kjo masë nxiti pakënaqësi në mesin e popullatës serbe në

Kosovë, të cilët bllokuan rrugët që çonin në pikëkalimet kufitare me Serbinë, në Jarinjë dhe Bërnjak. Për t'i ulur tensionet, me ndërmjetësimin e bllokut, më 30 shtator 2021 u arrit marrëveshja e përkohshme për targat. Kjo marrëveshje, që kishte për qëllim të ishte në fuqi për gjashtë muaj derisa grupet punuese të Kosovës dhe Serbisë të gjenin një zgjidhje afatgjatë, bëri që shoferët me targa të Kosovës dhe me ato të Serbisë të vendosnin letra ngjitëse në simbolet shtetërore në targa sa herë që kalonin kufirin e këtyre dy shteteve.

Mbrojtja e privatësisë ende në nivel jo të kënaqshëm në Kosovë

PRISHTINË, 28 JANAR - Lëvizja FOL, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave, ka mbajtur një diskutim me komisionaren për Informim dhe Privatësi, Krenare Sogojeva-Dermaku, në forumin "FOL Hapur". Tema të diskutimit ishin: Shkelja e privatësisë nga faturat e hapura; Të dhënat personale dhe mbrojtja e tyre e sektorin shëndetësor dhe atë

arsimor; si dhe Mbrojtja e të dhënave, media dhe interesi publik.

Sogojeva-Dermaku ka thënë se vendet e zhvilluara evropiane kanë ecur shumë në mbrojtjen e të dhënave, ndërsa në Kosovë ndërgjegjësimi për mbrojtjen e të dhënave dhe të privatësisë ende nuk është në nivelin e kënaqshëm. "Sado që kemi punuar në të gjitha fushat,

përsëri numri i ankesave që parashtrahet te ne për ta mbrojtur privatësinë është i vogël. Përsëri kur i shohim çdo ditë, çdo hap, kudo që kemi dyshime që kemi shkelje të privatësisë, veprojmë. Privatësia fillon nga vetë individi. Niveli i përgjegjësisë në Kosovë ende është në nivel jo të kënaqshëm", tha komisionarja Sogojeva-Dermaku.



Quinti kërkon pezullimin e zbatimit të vendimit të BQK-së për dinarin

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 JANAR - Ambasadorët e shteteve të Quintit kanë kërkuar që Kosova ta pezullojë zbatimin e rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës, që parasheh se monedha e vetme në Kosovë për pagesa të jetë euro.

Përmes një deklaratë të përbashkët, ambasadorët e Quintit thanë se pezullimi i vendimit do të duhej të bëhej për të "mundësuar një periudhë të mjaftueshme tranzicioni dhe për komunikim të qartë dhe efektiv publik. "Çështja duhet të diskutohet më tej në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian", u tha në deklaratë.

Ambasadorët e Quintit thanë se rregullorja e BQK-së për operacionet me para të gatshme, që pritet të hyjë në fuqi më 1

shkurt, synon t'i shkurtojë paratë e falsifikuara dhe ta ruajë stabilitetin financiar, po ashtu "ngre shqetësime në lidhje me ndikimin në veçanti në komunitetet me shumicë serbe". "Ne jemi të shqetësuar për ndikimin e rregullores, në veçanti në shkollat dhe spitale, për të cilat asnjë proces alternativ nuk duket i zbatueshëm për momentin. Rregullorja, gjithashtu, do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e përditshme të shumicës së serbëve të Kosovës që marrin pagesa/ndihma financiare nga Serbia", u tha në deklaratën e ambasadorëve të Quintit.

Në Quint bëjnë pjesë Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania, Italia dhe Britania. Përfaqësuesit e këtyre shteteve u takuan më 26 janar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për të diskutuar për këtë çështje.

Kurti, sipas njoftimit, gjatë këtij



takimi kishte kërkuar nga ambasadorët e Quintit ta respektojnë vendimin e BQK-së.

"Kryeministri Kurti në takim theksoi rëndësinë e respektimit të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë në vend nga të gjithë dhe në të njëjtën kohë respektimin e autoriteteve të

pavarura, në këtë rast të Bankës Qendrore", thuhej në njoftimin e Zyrës së Kurtit.

Ditë më parë Uashingtoni kërkoj që Kosova ta rishqyrtojë vendimin, që do t'u pamundësonte serbët që jetojnë në Kosovë ta përdornin dinarin serb për të bërë transaksione me

dinar.

Bashkimi Evropian, ndërkaq, ka thënë se ka kërkuar sqarime nga Kosova për këtë vendim.

Në Kosovë, në të gjitha vendbanimet me shumicë serbe, popullsia përdor dinarin serb për të kryer pagesa dhe ata që punojnë në institucionet serbe në Kosovë, i marrin edhe pagat me dinarë.

Me dinarë paguhen edhe pensionet, sipas sistemit serb, si dhe shtesat për fëmijë dhe ndihmat sociale.

Në objektet tregtare, në zonat ku banojnë serbët në Kosovë, përveç euros, përdoret edhe dinari.

Kundër këtij vendimi të BQK-së, që do ta pamundësonte përdorimin e dinarit, ka dalë Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, që ka mbështetur e Beogradit zyrtar. Sipas këtij subjekti, vendimi i BQK-së rrezikon mbijetesën e serbëve në Kosovës.

"Ky është vendi im", liberalizimi i vizave s'i largon turistët kosovarë nga Boga

PRISHTINË, 28 JANAR - Këpucët e dimrit të fëmijëve dhe shtresat e lëmuara të sajave lënë shenja mbi dëborën që vezullon nën rrezet e diellit.

Edhe në temperatura nën zero gradë celsius, pista e skijimit në fshatin Bogë në Pejë - pjesa perëndimore e Kosovës - ka joshur dhjetëra turistë nga zona të ndryshme të vendit në një ditë me diell në fund të janarit.

Duke tërhequr një sajë prapa vetes, Mimoza Dreshaj argëton djalin e saj pesëvjeçar. E lindur në këtë fshat, ajo kthehet këtu çdo dimër për ta shijuar bardhësinë e borës dhe kënaqësinë e sporteve dimërore, si skijimin. "Ky është vendi im. Jo që nuk kam mundësi të udhëtoj jashtë shtetit, por unë dua ta mbështes vendin tim", thotë Mimoza për Radion Evropa e Lirë.

Që nga 1 janari Mimoza dhe të gjithë ata që kanë pasaporta biometrike të Kosovës mund të udhëtojnë nëpër vendet e zonës Schengen, ku kryesisht përfshihen shtetet e Bashkimit Evropian, pa pasur nevojë të pajisen me viza turistike paraprakisht.

Edhe para liberalizimit të vizave Mimoza tregon se ka udhëtuar nëpër vende të ndryshme të Evropës, por destinacionin e vetëm për familjen e saj gjatë dimrit ka qenë Boga. "Si të bjerë pak borë ne duhet të jemi këtu patjetër. Pavarësisht prej mundësive, se ndoshta infrastruktura mungon, por bashkëfshatarët këtu e zhvillojnë mirë turizmin", thotë Mimoza, që tani jeton në qytetin e



Pejës.

Në vitet e fundit numri i turistëve në rajonin e Pejës nga pjesë të tjera të Kosovës është rritur dukshëm, veçanërisht kur merret parasysh numri i netëve që ata kanë qëndruar nëpër hotele apo vila turistike.

E me gjithë mundësinë që pasionin e skijimit ta praktikojë në pista më të zhvilluara në vendet e ndryshme të Evropës, Mimoza nuk tundohet nga këto opsione. "Të gjithë këta njerëz që punojnë e ndërtojnë këtu ne duhet t'i mbështesim. Nëse ne nuk i vizitojmë, atëherë kush tjetër...?!", thotë ajo, duke shtuar se i di sfidat e fshatrave të Bogës, që shpeshherë thotë se përballen me mungesë rryme e rrjeti telefonik. Problemet e infrastrukturës i përjetoi atë të hënë edhe Arianit Berisha, një i ri nga Peja, që po skijonte në Bogë bashkë me shokët e ngushtë.

Pasi e ngjiti një pjesë të pistës përmes linjës teleferike, Arianiti

mbeti në pritje që linja të fillonte të lëvizte sërish. Pas rreth 15 minutave, ai u dorëzua dhe filloi të skijonte nga ajo zonë. Me gjëra të tilla ai tregon se nuk është përballur gjatë udhëtimit të tij në Zvicër e Austri, ku ka skijuar. Por, Boga e josh për shkak të afërsisë dhe mundësisë që ta vizitojë çdo vikend. "Vij këtu me shokë, sepse është afër. Pimë ndonjë birrë dhe lëshohemi me ski. Por, dallimi me Zvicër e Austri është si nata me ditë", thotë Arianiti.

Për këtë dallim është i vetëdijshëm edhe një tjetër turist në Bogë, Berat Musliu nga Vushtrria. Me tre fëmijët e tij përkrah vetes, Berati tregon se, megjithatë, këtë rajon e viziton një ose dy herë në vit. "Kryesisht shkojmë në vendet malore të Kosovës për shkak të skijimit. Klima ka ndryshuar paksa dhe në shumë vende të Kosovës po ka pak borë. Vetëm vendet malore ta japin mundësinë për ta shijuar pak dimrin dhe për të

skijuar", thotë ai.

Berati nuk e përjashton mundësinë që së shpejti ta provojë skijimin edhe ndokund tjetër në Evropë, por shpreson se edhe Kosova do të bëjë më shumë për të investuar në qendrat e skijimit që ka.

Qeveria e Kosovës e ka zhvillimin e sektorit të turizmit pjesë të programit qeverisës për vitet 2021-2025. Në këtë program vëmendje të veçantë merr turizmi malor, që përfshin qendrat e skijimit, rritjen e kapaciteteve akomoduese njerëzore dhe përmirësimin e infrastrukturës përkatëse.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ku gjendet edhe Departamenti për Turizmin, nuk u përgjigj në pyetjet e REL-it lidhur me këtë temë, veçanërisht për ndikimin që mund ta ketë liberalizimi i vizave në turizmin e brendshëm në Kosovë.

Pronarë të vilave përreth qendrës së skijimit në Bogë i thanë REL-it se nuk kanë vërejtur ndonjë rënie të numrit të turistëve pas liberalizimit të vizave.

Njëri, megjithatë, tha se numri ka qenë në rënie në vitet e fundit, ndërsa një tjetër tha se vetëm mungesa e borës ndikon në rënie të turistëve.

Kosova është e ndarë në pesë rajone turistike: rajoni qendror i Prishtinës; rajoni turistik i Alpeve Shqiptare - Bjeshkët e Nemuna; rajoni turistik i Sharrit; rajoni turistik i Anamoravës dhe rajoni turistik i Mitrovicës.

Brezovica, Malet e Sharrit, Gryka e

Rugovës, Shpella e Gadimes, Ujëvara e Mirushës, Burimi i Drinit të Bardhë, Prevala dhe disa monumente kulturore janë destinacione të njohura turistike.

Një profesor i gjeografisë në Shkollën Filllore "Mazllum Këpuska" në Gjakovë, Kushtrim Rogova, është frekuentues i të gjitha këtyre destinacioneve. Megjithatë, para se të vendoste të shkonte në Bogë këtë herë, ai kishte shqyrtuar mundësinë ta shfrytëzonte pushimin për të udhëtuar diku tjetër në Evropë. "Ta them të drejtën e kam pasur dilemë. Edhe e kam plan për të ardhmen e afërt që të shkoj në një vizitë diku. Por, s'do të thotë që tash të sillemi sikur të na kishin zgjidhur, të vrapojmë krejt [drejt vendeve të zonës Schengen]", thotë Kushtrimi.

Ai tregon se bashkë me bashkëshorten dhe pjesëtarët e tjerë të familjes viziton shpeshherë qendrat e skijimit nëpër Kosovë, si në Bogë, Brezovicë e Brod. Udhëtimet e tij i përcjell edhe me fotografi, të cilat më vonë i publikon në "Instagram". "Kam dëshirë ta promovoj vendin tim. Mendohej se më shumë ta nxis atdhedashurinë edhe të nxënësit. Kam qejf t'ua fus në zemër", thotë Kushtrimi teksa shijon pamjet e Bogës nga një karrige përkrah bashkëshortes.

Fshati i Bogës gjendet rreth 1 400 metra në lartësi mbidetare, pranë majës së Hajlës. Fshati, ku në vitet e fundit janë ndërtuar shumë vila e resorte turistike, është i rrethuar nga malet e Rugovës.

Për të shpëtuar Ukrainën, demokratët duhet të bëjnë kompromis për imigracionin

Nga Dov S. ZAKHEIM,
The Hill

Në fillim të kësaj jave, zyrtarët amerikanë, të udhëhequr nga Sekretari i Mbrojtjes Lloyd Austin, u takuan me përfaqësues të më shumë se 50 vendeve që po mbështesin Ukrainën.

Pjesëmarrësit krijuan nëngrupe që do të fokusoheshin në drone dhe forca të blinduara. Austin u tha zyrtarëve të mbledhur se "Putini shpreson që raketat dhe dronët do të demoralizojnë popullin ukrainas dhe do të shkatërrojnë shpirtin luftarak të ushtrisë ukrainase.

Nëse humbasim nervat tona, nëse nuk arrijmë të pengojmë agresorët e tjerë të mundshëm, ne vetëm do të shkaktojmë edhe më shumë gjakderdhje dhe kaos."

Megjithatë, janë Shtetet e Bashkuara që duket se po humbasin durimin e tyre. Në fund të dhjetorit, administrata njoftoi një paketë armësh dhe pajisjesh prej 250 milionë dollarësh, raporton abcnews.al.

Çelësi i mbështetjes shtesë për Ukrainën është kërkesa shtesë e administratës për Ukrainën, Izraelin dhe Tajvanin.

Megjithatë, fati i saj mbetet në rastin më të mirë i pasigurt. Rezoluta e fundit e njëkohshme që Kongresi miratoi në fillim të këtij muaji përcaktonte 8 Marsin si

afatin përfundimtar për miratimin e projektligjeve të ndarjeve të vitit fiskal 2024 për Departamentin e Mbrojtjes dhe të Shtetit, ndër të tjera.

Këto janë agjencitë përmes të cilave financohet pjesa më e madhe e ndihmës për Ukrainën. Republikanët e Dhomës së Dhomës së djathtë, të nxitur nga ish-presidenti Donald Trump, kundërshtojnë një shtesë në dy pika kryesore.

Ata argumentojnë se në vend që të miratohen miliarda dollarë shtesë në Ukrainë, këto fonde duhet të shpenzohen për Amerikën ose, më mirë akoma, të mos shpenzohen fare.

Përveç kësaj, kundërshtarët refuzojnë dispozitat e saj mbi kontrollin kufitar, të cilat ata i konsiderojnë shumë të dobëta.

Në të vërtetë, edhe pse negociatorët e Senatit dhe Dhomës së Përfaqësuesve po përpiqen të arrijnë një kompromis mbi dispozitat e kontrollit kufitar të shtesës, konservatorët e Senatit po i bëjnë jehonë kundërshtimeve të homologëve të tyre të Dhomës.

Në veçanti, kundërshtarët e Senatit kanë shprehur shqetësime për një dispozitë në negociatat aktuale midis demokratëve të Senatit dhe republikanëve që thuhet se do t'i jepte presidentit autoritetin për të dëbuar emigrantët pa u përpunuar për azil vetëm pasi 5000 të kenë hyrë në SHBA çdo

ditë. Megjithatë, çdo marrëveshje që Senati arrin dhe dërgon në Dhomën e Përfaqësuesve ka të ngjarë të dështojë, raporton abcnews.al.

Kryetari Mike Johnson thuhet se do të mbështesë fonde shtesë për Ukrainën, megjithëse ndoshta në një shumë më të ulët se më shumë se 61 miliardë dollarë në kërkesën shtesë të administratës. Megjithatë, ai nuk ka gjasa të pranohet ndonjë propozim të Senatit që nuk plotëson shumicën e standardeve të ashpra për imigracionin që kërkojnë republikanët.

Në të vërtetë, ka presion në grupin GOP të Dhomës së Përfaqësuesve për të refuzuar çfarëdo legjislacioni mbi imigracionin, pasi miratimi padyshim që do ta lejonte administratën Biden të shpallte fitoren në një nga çështjet më të diskutueshme të vitit zgjedhor.

Të gjitha janë sinjale të këqija për perspektivat e Ukrainës në përpjekjet e saj të vazhdueshme për të zmbrazur pushtuesit e Rusisë.

Ushtria ukrainase ka nevojë dëshpërimisht për materiale të të gjitha llojeve duke pasur parasysh humbjet e saj të rënda të personelit, të cilat, ndryshe nga Rusia, e ka jashtëzakonisht të vështirë për t'i zëvendësuar.

Për më tepër, numri i madh i viktimave që forcat ruse po i shkaktojnë ushtrisë ukrainase po

vazhdon të dëmtojë moralin si të trupat ashtu edhe të civilët.

Por pavarësisht Sekretarit Austin, miqtë e Ukrainës në Europë dhe gjetkë nuk ka gjasa të pranojnë plogështinë që rezulton nga një dështim amerikan për të ofruar ndihmë shtesë për Kievin.

Nuk është për mungesë mbështetjeje për Ukrainën që ata nuk do të jenë në gjendje ta bëjnë këtë. Disa vende të NATO-s kanë programe ambicioze për të rritur shpenzimet e tyre të mbrojtjes në përgjigje të agresionit të Moskës. Ndërkohë, shtetet që i kanë ofruar ndihmë të konsiderueshme Ukrainës, kanë pakësuar stoqet e tyre deri në atë pikë sa janë të shqetësuar për aftësinë e tyre për të mbrojtur territorin e tyre në rast të aventurizmit të ri rus.

Shumë ekspertë, mes tyre edhe vetë Lloyd Austin, kanë theksuar se nëse Amerika do të hiqte dorë nga ndihma e saj për Ukrainën, premtimet e saj për mbështetje për Tajvanin do të humbin të gjithë besueshmërinë.

Ky vëzhgim vlen njëloj për angazhimin e Amerikës ndaj aleatëve dhe partnerëve të saj europianë.

Ata gjithashtu do të arrijnë në përfundimin, në të vërtetë tashmë janë shqetësues se pavarësisht se kush i fiton zgjedhjet presidenciale, prirja në rritje e Amerikës për të mbrojtur vetën do të intensifikohet, raporton abcnews.al.

Çdo shpresë për miratimin e saj do të kërkojë qartë lëshime për republikanët veçanërisht ata në Dhomën e Përfaqësuesve për kontrollin e kufijve që do t'u mundësonte atyre të shpallin fitoren me aq zë të lartë sa demokratët janë të sigurt për të bërë.

Prandaj, çdo paketë e Senatit duhet të krijojë hapësirë për lëshime në Dhomën e Përfaqësuesve, duke i mundësuar kryetarit Johnson që shumica e grupeve të tij

Nëse Johnson nuk mund ta bëjë këtë, nuk do të jetë vetëm Ukraina ajo që do të lihet në mëshirën e Rusisë. Në vend të kësaj, i gjithë sistemi ndërkombëtar, i ndërtuar mbi themelin që Uashingtoni hodhi gati tre të katërtat e një shekulli më parë, mund të shpërbëhet tragjikisht, në dobi të armiqve më të vendosur të Amerikës.

Dov S. Zakheim është një këshilltar i lartë në Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare dhe nënkryetar i bordit për Institutin e Kërkimeve të Politikës së Jashtme.

Ai ishte nënkryetar i Mbrojtjes dhe shef financiar për Departamentin e Mbrojtjes nga viti 2001 deri në 2004 dhe zëvendës nënkryetar i Mbrojtjes nga 1985 deri në 1987.

Përktheu: abcnews.al



A do ta vrasin podkastet dhe audio-librat, radion që ne njohim?



Nga: Charlotte Runcie /
The TELEGRAPH
Përkthimi: Telegrafi.com

Në vitet 1990, kisha këtë risi të FM-radios që ishte në formën e [karaktereve të serisë së animuar] Wallace dhe Gromit ulur në dhomën e tyre të ndenjjes. Doreza e volumit ishte tasi i qenit Gromit dhe e caktoje stacionin që doje duke përdredhur taburenë me pika të verdha. E kam këtë kujtim të lëvizjes nëpër frekuenca, për zhurmën që ia lëshonte vendin muzikës dhe fjalës, e që më pas zhdukej sërish në eter.

Kur isha fëmijë, radioja ishte diçka që si me magji dilte nga statika. Kishte diçka teknike në dëgjim, sepse përfshinte funksionimin e makinerive për të gjetur kuptimin mes zhurmës – edhe nëse ishte tetë vjeçe. Edhe nëse pajisja ishte në formën e një qeni plastik!

Këto ditë dëgjojmë radio përmes altoparlantëve inteligjentë që përgjigjen, si qeni, ndaj komandave verbale. Thjesht mund të thoni, “Lëshoje Radio 3-

shin!” dhe Radio 3 do të fillojë. Ka ende magji, por në një mënyrë tjetër. Ndonjëherë ndihet pak më shumë si kërkim sesa dëgjim. Dhe, për mua është një mrekulli e përditshme që nëpërmjet një radioje në internet ose një altoparlanti me blututh, mund të dëgjoj radion që është kudo në botë, menjëherë dhe në çdo gjuhë. Më bën shpresëdhënëse për të ardhmen me lidhjet më të mëdha ndërnyerëzore, saqë ndonjëherë për këtë edhe emocionohem.

Por, zgjedhja do të thotë konkurrencë dhe kjo gjithashtu nënkupton se disa lloje të radiove që jemi të aftë t’i bëjmë në Britani – domethënë radio të fjalimeve ose emisione të drejtpërdrejta të bisedave dhe me muzikë – duhet të luftojnë për vendin e tyre në zemrat e dëguesve. Radioja dikur ka qenë një pajisje specifike në kuzhinë ose në makinë ose pranë shtratit. Por, radioja tani është vetëm një pjesë e një ekosistemi mediatik gjithëpërfshirës të audios. Dëshironi të ndiqni episodin më të fundit të In Our Time në BBC Sounds apo dëshironi të dëgjoni drejtpërdrejt shfaqjen e Chris

Evansit në Virgin Radio? Apo dëshironi të dëgjoni 12 episode të atij podkasti investigativ që përmendi kolegu yt? Po romani i ri për të cilin të gjithë po flasin, me audio-librin e lexuar nga një aktor i famshëm?

Veshët tanë kurrë nuk kanë qenë më kërkues. Dhe, nuk kemi pasur kurrë më shumë kohë për të dëgjuar: kemi kaluar nga radiot me valë te kufjet me valë dhe tani mund të dëgjojmë kudo dhe vazhdimisht. Një shoqe e imja kohët e fundit bëri shaka se ka kaluar aq shumë kohë me AirPods-et, saqë ishte e shqetësuar se do të harrojë t’i nxjerr në dasmën e vet. Nuk jemi më të kufizuar në kapjen e programeve gjysmorëshe në udhëtimet me makinë; mund të dëgjojmë qindra episode të një podkasti të preferuar, ose nëntë orë të një audio-libri të pashkurtuar, gjatë gjithë ditës, dhe ende të kërkojmë më shumë. Tani, sa herë dikush flet për të ardhmen e radios, në të vërtetë flasin për të ardhmen e audios. Duhet të pranojmë se FM-radioja me transmetimet e drejtpërdrejta nuk do të zgjasë përgjithmonë, pasi shkurtime të ofrimit e

radios lokale bëhen gjithnjë e më të mëdha dhe investimet e sektorit tregtar dhe publik po kalojnë në internet. Gjithnjë e më shumë dëgjojmë atë që duam, kur duam, në vend që hasjen në ndonjë kanal ta cilësojmë si fat. Nuk ka asgjë të zymtë në lidhje me këtë edhe nëse, e pranoj, jam gjithashtu nostalgjike për të papriturat e radios së dikurshme. Vlen të kujtohet se burimet zyrtare të radiove të debateve spontane, në këtë vend, janë kufizuar te Radio 3 dhe Radio 4 të cilat kanë paguar për licencim për dekada me radhë. Tani, megjithatë, teknologjia e incizimit është më e lirë dhe më e disponueshme dhe modelet e reja të reklamimit të podkasteve nënkuptojnë që krijuesit e audios mund të bëjnë diçka, ta vendosin atë në internet, të arrijnë dëguesit dhe të fitojnë para të mjaftueshme për ta mbështetur veten.

Ekziston ende një ndjenjë legjitime për stacionet dhe rrjetet tradicionale të radios, por për sa i përket krijimtarisë dhe inovacionit, kjo është ndoshta koha më emocionuese për audion – qëkur u shpik për herë

të parë tingulli i incizuar. Mendoj se kjo është e ardhmja e radios: narrativat e gjata, audio-librat dhe podkastet e pakufizuara, si dhe producentë kreativë radiofonikë që bëjnë vepra kuptimplote dhe personale – drejtpërdrejt për audiencën e tyre besnike dhe të angazhuar.

Radioja e drejtpërdrejtë në stacionet dhe rrjetet konvencionale, shpejt mund të jetë diçka krejt e panjohur. Me më shumë gjëra për të dëgjuar se kurrë më parë, është më e rëndësishme se kurrë të mbështesim producentët dhe zërat që këtë po e bëjnë. Disa audio-tendenca tashmë janë në rënje. Do të habitesha nëse podkastet e krimit për gratë e vrara do të ekzistojnë ende, në të njëjtën formë, për shembull në 10 vjetët e ardhshme.

Po kështu, dyshoj se radiostacionet lokale do të mbijetojnë shumë më gjatë në formën e tyre aktuale. Nga ana tjetër, audio-prodhimi i pavarur i projekteve të pasionit, të tilla si podkastet hiper-specifike të paraqitura nga ekspertët, për çdo gjë ... mund të dominojë çdo herë e më shumë. /Telegrafi/

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON Invert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Peja pa problem mposhti Istogun, Trepça regjistron fitoren e dymbëdhjetë



“Epoka e re”

PRISHTINË, 28 JANAR - Skuadra e Pejës ka triumfuar në pa ndonjë problem në përballjen ndaj Istogut me rezultat 80:53 (26:14, 19:11, 21:8, 14:20). Kjo përballje i ka takuar javës së 19-të të Prince Caffè Superligës. Pejanët e nisën ndeshjen më mirë dhe qysh në çerekun e parë krijuan epërsi të lartë, duke e fituar këtë pjesë 26:14. Kampionët vazhduan me lojë të mirë dhe thelluan më shumë epërsinë, për të shkuar në pushim me shifrat 45:25. Në pjesën e dytë nuk kishte ndonjë ndryshim të madh me vendasit që ruajtën epërsinë dhe triumfuan 80:53. Larry Thomas u dallua te Peja me 19 pikë, shtatë kërcime dhe gjashtë asistime, derisa Arian Azemi kishte 15 pikë e pesë asistime te Istogu. Peja është e dyta me 14 fitore e pesë humbje, derisa istogasi në vendin e fundit

me një fitore e 18 humbje. Trepça ka vazhduar me formë të lartë, duke shënuar fitoren e 12-të radhazi në elitë, ndërsa nuk e kishte aspak lehtë përballë Proton Cable Prizrenit, ku mitrovicasit triumfuan në çastet e fundit 68:71 (12:18, 25:14, 15:18, 16:21). Fillimi i ndeshjes ishte i barabartë, por në katër minutat e fundit të kësaj pjese, vendasit shënuan vetëm dy pikë, përkundër nëntë sa shënuan mysafirët, duke përfunduar kjo pjesë 12:18. Mitrovicasit vazhduan me lojë të mirë dhe në periudhën e dytë kishin deri në dhjetë pikë epërsi 20:30, por nga ky moment prizrenasit me një seri të jashtëzakonshme prej 17:2, shkuan në pushim me rezultat 37:32. Lojë interesante u vazhdua në pjesën e dytë, ku tre minuta nga fundit, prizrenasit po fitonin 64:59, megjithatë në çastet vendimtare, mitrovicasit ishin më të vëmendshëm 68:71. Isaiah Kelly

ishte më i miri te vendasit me 16 pikë e dhjetë kërcime, derisa Jordy Tshimanga ishte më i miri te mysafirët me 18 pikë e 14 kërcime. Proton Cable Prizreni ka pesë fitore e 14 humbje, kurse Trepça 17 fitore e dy humbje. Në një sfidë, ku fituesi është vendosur në sekondat e fundit, Sigal Prishtina ka mundur Bashkimin me rezultat 84:83 (31:25, 17:27, 16:11, 20:20). Te Prishtina u dalluan Derrick Wilson me 18 pikë e 12 asistime dhe Shaheed Davis me 20 pikë e shtatë kërcime, kurse te Bashkimi u dalluan Will Daniels me 24 pikë e dhjetë kërcime, Isiah Umpig me 16 pikë e 11 asistime dhe Altin Morina me 17 pikë. Ndërsa Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore shumë të rëndësishme ndaj Vëllaznimit në Gjakovë me rezultat 56:63 (16:17, 5:15, 15:19, 20:12). Myeron Jones ishte më i miri te kuqezinjët me 17 pikë, derisa 17 pikë te therandasit realizoi Jalen Nesbitt.

SHKURT

Zekaj dhe Kuka eliminohet nga Grand Prix i Portugalisë

Loriana Kuka dhe Shpati Zekaj janë eliminuar nga Grand Prix-i i xhudos, që po mbahet në Odivelas të Portugalisë. Të dy pësuan humbje në përballjet e tyre të para. Kuka, që garon në kategorinë deri në 78 kilogramë, u mposht nga kroatja, Karla Prodan. Ndërsa, Zekaj pësoi ndaj francezit, Francis Damier. Shpati Zekaj garoi në kategorinë deri në 100 kilogramë.

Sinner triumfon në Australian Open

Tenisti italian, Jannik Sinner, ka fituar çmimin e madh të tenisit, Australian Open, pasi në finale përmbysi rusin, Daniil Medvedev, me rezultat 3-2 në sete, në duelin që zgjati afro 4 orë. Medvedev fitoi dy setet e parë me shifrat e njejta, 3-6, ndërsa Sinner barazoi rezultat duke fituar në dy setet vijues me shifrat 6-4. Në setin e fundit dhe përcaktues, italiani realizoi përmbysjen duke fituar me shifrat 6-3. Ky ishte edicioni i 112 i Australian Open dhe titulli i parë i Jannik Sinner në një “Grand Slam” apo garë madhore të tenisit.

Franca shpallet kampione e Evropës në hendboll

Ka përfunduar Kampionati Evropian i hendbollit i mbajtur në Gjermani. Finalja mes Francës dhe Danimarkës është vendosur vetëm pas vazhdimëve nga pesë minuta. Ishin francezët që festuan në fund, duke fituar me rezultat 33:31. Danimarka ka udhëhequr shumicën e kohës, por fituesi nuk u vendos pas 60 minutave lojë, që përfunduan me 27:27. Në vazhdimet nga pesë minuta, francezët i shënuan gjashtë gola dhe i pranuan katër për titullin e katërt të Evropës dhe të parin pas dhjetë vjetësh. Ludovic Fabregas ishte më efikas te Franca me tetë gola. Legjenda Mikkel Hansen i shënoi nëntë gola për Danimarkën, ndërsa portieri Emil Nilsen ishte i shkëlqyer me 15 pritje. Ai edhe u shpall më i miri i finales. MVP i Evropianit u shpall Nedim Remili, që realizoi gol shumë të rëndësishëm edhe në finale. Në ndeshjen për vend të tretë, Suedia e mposhti Gjermaninë me rezultat 34:31.

Arrihet marrëveshja për transferimin e Zybës në Legia

SUHAREKË, 28 JANAR - Qëndrim Zyba do të bëjë një hap të madh në karrierën e tij, duke nënshkruar me klubin e madh nga Polonia, Legia Varshavën. Kjo lëvizje vije pasi klubi nga kryeqyteti polak kishte vëzhguar për një kohë mesfushorin e Ballkanit. Sipas mediumit nga Polonia “TVPSport”, nën-kampionët e

këtij vendin patën mundësi ta vëzhgonin Zybën në Turqi, atje ku kryen përgatitjet për pjesën e dytë të sezonit siç bëri edhe Ballkani. Raportohet se tashmë është arritur një marrëveshje mes klubeve dhe 22-vjeçari do t’u nënshtrohet testeve mjekësore në Legia në ditët në vijim. Çështja e transferimit pritet të

përmbillet brenda tre ditëve të ardhshme. Transferimi do të jetë në bazë të përhershme, teksa klubi nga Theranda besohet se do të përfitojë 500 mijë euro nga shitja e Zybës. Zyba është pjesë e Ballkanit nga viti 2022, kur kishte kaluar nga Prishtina. Ai numëron edhe katër paraqitje me Kombëtaren e Kosovës.





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datë, 29.01.2024

Në bazë të neneve 30, 31, 33 dhe 35 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, neneve 29, 30, 31, 32, 33 si dhe 34 të Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë, dhe nenet 3, 5, 9, 11, 12 dhe 13 të Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve në Institutin e Historisë "Ali Hadri", Institutin e Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë shpallë:

KONKURS

1. (1) Bashkëpunëtor i lartë shkencor për periudhën në mes të Dy Luftërave Botërore-zgjedhje/rizgjedhje.

Kandidati/ja për Bashkëpunëtor të lartë shkencor (prof. asoc.) duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë gradën e doktorit të shkencave,
- Të ketë të botuar së paku tri (3) punime shkencore në revistat relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmisë përkatëse, dy (2) prej tyre pas zgjedhjes së fundit,
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit,
- Të ketë pjesëmarrje me kumtesa së paku në dy (2) konferenca, nga të cilat së paku një (1) të jetë ndërkombëtare.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse,
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj,
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk është nën hetime,
- CV së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të,
- Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj).

Zgjedhja e personelit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, Ligjit të Punës nr. 03/L212, Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri", dhe Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe rizgjedhjes së punëtorëve shkencorë dhe hulumtuesve të Institutit të Historisë.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në njëri nga gazetaret ditore.

Kërkesës i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës.

Kërkesat e kompletuara dorëzohen në adresën: Institutin e Historisë në Prishtinë, (Ndërtesa e Agjencisë Shtetërore të Arkivave të Kosovës), Rr., Arbnor e Astrit Dehari" nr. 25 - 10000 Prishtinë.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/512-303, prej orës 09:00 - 16:00.



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRIŠTINA

Datum, 29.01.2024

Na osnovu članaka 30, 31, 33 i 35 Zakona br. 04/L-135 O Naučno-istraživačkoj Djelatnosti - (Službene Novine Republike Kosova, br 11/02 Maj 2013); Član 8 Zakon o Radu Br. 03/L-212; članovi 29, 30, 31, 32, 33 i 34 Statuta Instituta za Istoriju "Ali Hadri" u Prištini; i članovi 3, 5, 9, 11, 12 i 13 Uredba o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju, Institut za istoriju "Ali Hadri" u Prištini, objaviti:

KONKURS

2. 1 (Jedan) Viši naučni saradnik za period između dva svetska rata- izbor/reizbor.

Kandidata za poziciju Viši naučni saradnik (Prof.asoc.) mora ispuniti sledeće uslove:

- Da ima doktorat nauka,
- Imati najmanje tri (3) naučne radove objavljena u relevantnim međunarodnim časopisima unutar oblasti, najmanje dva (2) od njih moraju biti nakon poslednjih izbora,
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima unutar i izvan zemlje,
- Da učestvuje sa referatima na najmanje dva (2) konferencije, od kojih je najmanje jedna (1) međunarodna.

Potrebna dokumentacija

Kandidat mora da dostavi sledeću dokumentaciju:


- Diplomu za završetak doktorskih studija,
- Izvod iz matične knjige rođenih koji nije stariji od šest meseci,
- Dokument izdat od nadležnog organa koji potvrđuje da nisu pod istragom,
- CV o čemu mora priložiti neophodne dokaze kako bi se dokazala situacija u njoj,
- Dokazi o naučnim dostignućima (članci, knjige itd.).

Izbor osoblja Instituta Istorija "Ali Hadri" bira se u skladu sa odredbama Zakona br. 04 / L - 135 za istraživačke- naučne aktivnosti - i Statuta Instituta Istorije "Ali Hadri" , Zakon o Radu, i Uredba o postupcima za izbor i reizbor naučnih radnika i istraživača Instituta za istoriju

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja u dnevnim novinama, Zahtev se prilažu (dodajte) kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i drugoj potrebnoj dokumentaciji koju zahteva radno mesto za koje se aplicira.

Kompletirani zahtevi dostavljaju se na adresu: Institut Istorije u Prištini, (Zgrada Arhiva Kosova). (Zgrada Državne Agencije za Arhive Kosova), Ul. "Arbnor e Astrit Dehari" br. 25 - 10000 Prishtinë.

Za detaljnije informacije možete se obratiti na ovom Br . Tel: 038 / 512 303, od 09:00 do 16:00 časova.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Xhevat Berisha nga Baran KK Pejë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Jemin Maroshi nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f. "Homëz Cena" Demjan KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Mentor Maroshi nga Damjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Homëz Cena" nga kl. I-V dhe VI-IX Damja KK Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

